

Kryetari Nura: Sa i përket ujëllësit projekti i shtrirjes së gypit ka përfunduar. Janë disa probleme sa i përket trafostacionit. Kemi përfundua procedurat e tenderimit për trafostacionin elektrik. Po e përseris edhe një herë, kontrata kolektive na ka shkaktuar telashe te këto projekte. Furnizimi me ujë është problem sepse qyteti është zgjeruar dhe janë rritur kërkesat për furnizim. Ndryçimi publik është duke u realizuar dhe po vazhdon hap pas hapi. Deri në qershor të vitit të ardhshëm pritet të përfundojë projekti i ndriçimit publik. Sa i përket resurseve ujore si komunë kemi pak resurse. Është lajm i mirë që ka filluar hartimi i projektit të Pendës së Kuqicës dhe realizimi i këtij projekti të madh do të zgjidh një herë e përgjithmonë çështjen e furnizimit të ujit të pijshëm. Sa i përket infrastrukturës rrugore, tash nuk kemi kërkesa për rrugë të gjata, kemi kërkesa për asfaltim të degëzimeve dhe rrugicave. Të gjitha rrugët kryesore në fshatra janë asfaltuar, kanë mbet vetëm degëzimet dhe rrugica të vogla.

Driton Mulaj, drejtor i Urbanizimit: Sa i përket kanalizimit, kemi vetëm dy lagje në Burojë që kanë mbet pa u përfshirë në sistem. Do të përfundojnë edhe këto. Sa u përket rrugëve që janë dëmtuar nga prerjet, këtë vit do të rregullohen edhe ato. Ndërkaq sa i përket ujit, do të fillojmë së shpejti testimet. Ndërkaq te rrugët, kemi kontratë për asfaltim dhe do të nisim shumë shpejt.

Murat Mehmeti: sa i përket ndërmarrjes Eko Natyra, është projekt i mirë se ardhur fuqizimi i saj, për cka ju përgëzoj për këtë projekt.

Kryetari Nura: Nëse nuk keni diçka tjetër, ne kemi parasysh vërejtjet dhe kërkesat që i parashtruat. Ju falënderoj për kontributin në këtë takim. Ne do të vazhdojmë punën në realizim të projekteve kapitale dhe që janë në dobi të interesit të qytetarëve.

Faleminderit dhe mirupafshim!

Procesmbajtësi:

Jeton Rushiti

